



në **ITALI**



sipas **PREGULLAVE**

NE BASHKËPUNIM ME
INTESA  SANPAOLO

A cura di:
Ministero dell'Interno

Realizzazione: Servizi Editoriali Srl - Via Pagliano, 37 - 20149 Milano

Foto di: Francesco Laera, Shutterstock, Ministero dell'Interno

Stampa: PuntoWeb Srl - Zona Industriale, Via Nettunense - 00040 Ariccia (Roma)

Përse janë hartuar udhëzuesit

Sot, njohja e informacioneve është një e drejtë që i përket të gjithëve e aq më tepër atyre që jetojnë larg nga vendi i tyre, duke përballuar vështirësitë e gjuhës dhe nevojën për t'ju përshtatur rregullave që shpesh janë të panjohura. Shfrytëzimi i informacioneve ndihmon imigrantët të jetojnë më mirë këtu në vendin tonë por na ndihmon edhe ne të jetojmë më mirë me imigrantët. Në fakt, njohja e rregullave është hapi i parë drejt respektimit të tyre për të jetuar ligjshëm.

Përmirësimi i ligjeve nuk mjafton nëse nuk jepen informacionet e duhura mbi rolin e secilit, mbi çfarë duhet bërë, si, ku dhe kur duhet vepruar. Me këtë botim, që do të azhurnohet herë pas here edhe në faqen e internetit www.interno.it, Ministria e Punëve të Brendshme bën një hap të mëtejshëm për të dhënë informacione gjithmonë e më të qarta e më të plota mbi procedurat dhe normat ligjore që kanë të bëjnë me Imigracionin, duke ju drejtuar një publiku imigrantësh por edhe të gjithë italianëve të interesuar, duke filluar nga punëdhënësit – familje o ndërmarrje – deri tek organizatat humanitare e strukturat institucionale.

Proçesi i informimit të imigrantëve mund të përbëjë një "reformë" po aq domethënëse sa reformat e tjera për thjeshtësimin e integritimit dhe të bashkëjetesës midis italianëve dhe të huajve. Është shumë e rëndësishme që qeveria të veprojë në bashkëpunim me të gjithë në këtë fushë.

Ministri i Punëve të Brendshme
Giuliano Amato



Treguesi

 Punësimi i parë i punonjësve të huaj	<i>faq.</i> 4
Lëshimi – përtëritja e lejeqëndrimit	<i>faq.</i> 5
 Lejeqëndrimet në Kuesturë	<i>faq.</i> 7
 Lejeqëndrimi “BE” për qëndrim afatgjatë	<i>faq.</i> 8
 Kërkesa për strehim politik	<i>faq.</i> 11
 Bashkimi familjar	<i>faq.</i> 14
 Të miturit e huaj	<i>faq.</i> 15
 Të huajt dhe zyra e gjendjes civile (anagrafe)	<i>faq.</i> 19
 Të huajt dhe arsimi	<i>faq.</i> 21
 Shërbimi sanitar për nënshtetasit e huaj	<i>faq.</i> 23
 Nënshtetësia	<i>faq.</i> 25

Parathënie

Me Udhëzuesit mbi imigracionin, Ministria e Punëve të Brendshme i jep mundësinë të huajve dhe nënshtetasve italian të interesuar të përdorin një mjet të ri për t'ju përgjigjur në mënyrë të thjeshtë të gjitha pyetjeve mbi procedurat që kanë të bëjnë me imigrantët.

Në 11 skeda, të thjeshta për t'u konsultuar, janë përshkruar procedurat për përtëritjen e lejeqëndrimeve, bashkimin familjar, marrjen e nënshtetësisë, regjistrimin në shkollë e kështu me radhë. Në këtë mënyrë, plotësohet nevoja për qartësi e transparencë, veçanërisht e ndjeshme nga ana e të huajve por edhe nga familjet dhe ndërmarrjet italiane të interesuara në procedurat që varen nga oferta e punës.



Përkthimi në shtatë nga gjuhët më të përhapura të imigrantëve të pranishëm në Itali – anglisht, frëngjisht, spanjisht, shqip, rusisht, arabisht e në gjuhë kineze – përbën një element qartësie plus.

Por procedurat dhe rregullat ndryshojnë. Për këtë arsye udhëzuesit do të plotësohen më tej në versionin telematik në faqen e internetit **www.interno.it** ku të gjitha skedat në fjalë do të azhurnohen vazhdimisht për të ecur në një hap me modifikimet legjislative dhe procedurale.



Punësimi i parë i punonjësve të huaj

Nëse dëshëron të punësosh punëtorë jo-komunitarë, me vendbanim jashtë shtetit, duhet të paraqesësh kërkesë për autorizim "nullaosta" pranë Sportelit Unik për Imigracionin (*Sportello Unico per l'Immigrazione*) të provincës ku banon ose të asaj ku ka qendrën ndërmarrja ose ku do të kryhet aktiviteti i punonjësit në bazë të kuotave vjetore të parashikuara nga "dekreti i flukseve" që përcakton numrin maksimal të shtetasve jo-komunitarë, që pranohen për të punuar në territorin italian.

1. Si paraqitet kërkesa

Nëse e njëj punonjës in që dëshëron të punësosh, duhet të paraqesësh në Sportelin Unik:

- kërkesë në emrin tënd për autorizim "nullaosta" për punë;
- dokumentacionin që vërteton mundësinë e një strehimi të përshtatshëm për punonjës in e huaj, sipas rregullave të parashikuara nga çdo krahinë (*Regione*);
- propozim kontrate qëndrimi që përmban, përveç elementeve thelbësorë të marrëveshjes, angazhimin tënd për pagesën e udhëtimit të kthimit të të huajit në vendin nga i cili vjen;
- deklaratë me të cilën merr përsipër t'i transmetosh Sportelit Unik çdo ndryshim në lidhje me marrëdhënien e punës (përfundim të marrëdhënies, ndryshim adrese etj).

Nëse nuk e njëj drejtpërdrejt punonjës in mund të kërkosh, duke paraqitur dokumentacionin e mësipërm, autorizimin "nullaosta" për punë për një o më shumë persona të regjistruar në listat e hartuara pranë përfaqësive diplomatike dhe konsullore italiane të atyre vendeve që kanë nënshkruar marrëveshje dypalëshe.

Këto lista, specifike për çdo shtet, përmbajnë një listë emrash me të dhënat personale të plota, kualifikimin profesional, nivelin e njohjes së gjuhës italiane, ç'marrëdhënie pune parapëlqehet (stinore, me kohë të kufizuar ose të pakufizuar), përshkrimin e formimit profesional të kryer si edhe të sektorit përkatës të punësimit.

2. Aktivitetet e Sportelit Unik për Imigracionin: Faza e Parë

Sporteli Unik, për t'i dhënë mundësinë Qendrës së Punësimit lokale (*CPI*) të reklamojë si duhet kërkesat e bëra për personat e regjistruar në listat e punësimit, ua shpërndan të dhënat CPI-ve të tjera territoriale në rrugë telematike dhe i publikon, po ashtu, në faqen e internetit, ose me çdo mjet tjetër të mundshëm.

Sporteli Unik:

- vihet në dijeni nga Kuestori nëse ka pengesa për dhënien e autorizimit "nullaosta" për punësimin dhe hyrjen e të huajit në Itali;
- vihet në dijeni nga Drejtoria Provinciale e Punës rreth plotësimit apo jo të kushteve minimale kontraktuale dhe të shpërbllimit të punëdhënësit.

Në rast përgjigjeje negative, qoftë edhe prej njëres nga këto zyra, Sporteli hedh poshtë kërkesën.

Në rast përgjigjeje pozitive:

- thërret punëdhënësin për dorëzimin e autorizimit "nullaosta" dhe për nënshkrimin e kontratës;
- i transmeton dokumentacionin zyrove konsullore në rrugë telematike.

duhet ditur se

Autorizimi "nullaosta" për punë të nënvarur vlen **6 muaj** nga data e lëshimit,

kohë gjatë të cilës punonjësi duhet të hyjë në Itali e të paraqitet pranë Sportelit Unik për të lidhur kontratën.

3. Çfarë duhet të bëjë punonjësi

Punonjësi i huaj pasi ka marrë autorizimin "nullaosta" që ti i ke dërguar si punëdhënës, duhet të kërkojë një takim me ambasadën ose konsullatën italiane në vendin e tij. Kjo e fundit, të cilës, në të njëjtën kohë, i është dërguar në rrugë telematike dokumentacioni që përfshin edhe autorizimin "nullaosta" përkatës, e njofton shtetasin e huaj mbi propozimin e kontratës dhe i lëshon vizën e hyrjes në Itali brenda **30 ditëve**, duke ia komunikuar po ashtu Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Punës dhe të Sigurimeve Shoqërore, INPS-it, dhe INAIL-it.

Brenda 8 ditësh që nga hyrja në Itali, punonjësi duhet të paraqitet pranë Sportelit që i ka lëshuar autorizimin "nullaosta" për të nënshkruar kontratën e qëndrimit dhe për të paraqitur kërkesën për lejeqëndrim përndryshe qëndrimi i tij në Itali do konsiderohet i parregullt.

4. Aktivitetet e Sportelit Unik për Imigracionin: Faza e dytë

Kur punonjësi paraqitet në Sportel:

- ✓ verifikohet viza e lëshuar nga autoritetet konsullore dhe të dhënat e gjendjes civile të punëdhënësit;
- ✓ dorëzohet çertifikata për lëshimin e kodit fiskal;
- ✓ nënshkruhet, nga ana e punonjësit të huaj, kontrata e qëndrimit;
- ✓ dorëzohet formulari i kërkesës për lejeqëndrim dhe i nisen të dhënat Kuesturës përkatëse.

5. Lëshimi i i lejeqëndrimit

Pas Sportelit Unik, punonjësi duhet të shkojë në një zyrë poste ku duhet të postojë formularin e tërhequr pranë Sportelit Unik bashkë me **paketën e posaçme (kit)**. Zyra e postës lëshon një kupon me dy kode personale (*userid dhe password*) nëpërmjet të cilave i interesuari, duke u lidhur me www.portaleimmigrazione.it, mund të ndjekë ecurinë e praktikës.

Kuestura do t'a njoftojë në adresën e përcaktuar në kërkesë apo me telefon, mbi datën e takimit në zyrat e saj për të kryer marrjen e shenjave të gishtave e të fotografive dhe më pas do të njoftojë sërish për dorëzimin e lejeqëndrimit.

Lëshimi – përtëritja e lejeqëndrimit

1. Kujt duhet t'i drejtohesh

Nëse je nënshkruar i huaj mund të kërkoresh për arsyet e renditura më poshtë, lëshimin ose përtëritjen e lejeqëndrimit pranë **zyrave të postës** ku dallohet sigla **Sportello Amico**. Për përpilimin e paketës së formularëve (**kit**) mund t'i drejtohesh bashkëve që marrin pjesë në këtë fazë eksperimentale apo një **patronati** pa asnjë shpenzim.

- ✓ Kujdestari
- ✓ Arsye fetare
- ✓ Banim i përzgjedhur (*residenza elettiva*)

- ✓ Studim (për më shumë se 3 muaj)
- ✓ Shërbim
- ✓ Strehim politik (përtëritje)
- ✓ Stazh për formim profesional
- ✓ Pritje për rimarrje nënshkruar
- ✓ Pritje për punësim
- ✓ Kartë qëndrimi për të huajt (që tashmë quhet lejeqëndrim BE për qëndrim të gjatë)
- ✓ Punë e pavarur
- ✓ Punë e nënvarur
- ✓ Punë e nënvarur stinore
- ✓ Familje

NË ITALI SIPAS RREGULLAVE

- ✓ Familje për të miturit 14-18 vjeçarë
- ✓ Qëndrim pune neni 27
- ✓ Kërkesë e statusit të apolidit (përtëritje) për ç'do arsye tjetër duhet t'i drejtohesh Kuesturës.

Nëse ke **autorizim "nullaosta"** dhe kërkon lëshimin e lejeqëndrimit për punë ose për arsye familjare drejtoju Sportelit Unik për Imigracionin.

Nëse je i huaj, i afërm i një nënshtetasi italian apo BE, dhe kërkon kartën e qëndrimit si i afërm i një nënshtetasi BE, mund të paraqesësh kërkesën nëpërmjet zyrës së postës ose drejtpërdrejt në Kuesturë.

2. Ç'duhet bërë në zyrën e postës

Në të gjitha zyrat e postës do të gjesh **paketën e verdhë (kit giallo) të formularëve që duhet të përpilosh** duke ndjekur me kujdes udhëzimet.

3. Ç'duhet bërë në Bashki ose në Patronat

Në këtë rast **nuk ke nevojë për paketën me formularë (kit)**. Për të përpiluar kërkesën mund të përfitosh asistencë falas dhe të kualifikuar.

4. Ku duhet dorëzuar paketa e formularëve

Paketa me formularë (*kit*) duhet dorëzuar në **Zyrat e Postës me Sportello Amico**, e zarfi duhet të jetë i hapur.

Kujtohu që duhet të tregosh gjithmonë pasaportën dhe, nëse je duke kërkuar përtëritjen, duhet të dorëzosh edhe një kopje të lejeqëndrimit me afat në mbarim.

Nëpunësi i postës të dorëzon një **kupon** që ja bashkëngjit lejeqëndrimit, afati i të cilit ta mbaruar dhe që zëvendëson e ka vlerën e kuponit që lëshonte më parë Kuestura.

5. Shpenzimet

- **27,50 euro**, me gjithë buletinin postar nëse kërkon lejeqëndrim për më shumë se 90 ditë. Faturën mund ta gjeni pranë zyrës së postës me *Sportello Amico*.
- **14,62 euro** për pullën-taksë.
- **30,00 euro** i duhen paguar punonjësit të

zyrës së postës kur dorëzohet kërkesa e plotësuar.

■ *nëse je i huaj, i afërm i një nënshtetasi italian ose i një nënshtetasi BE, dhe kërkon kartën e qëndrimit si i afërm i një nënshtetasi BE, nuk duhet të bashkëngjitesh as pullë-taksë, as faturën e pagesës për lejeqëndrimin elektronik.*

6. Për lëshimin e lejeqëndrimit

Zyra e Imigracionit e Kuesturës do të të thërrasë, për marrjen e shenjave të gishtave, me letër rekomandë dhe me sms në adresën *apo numrin telefonik të specifikuar në kërkesë* dhe do të të japë takim për të tërhequr lejeqëndrimin.

7. Informacione të dobishme

Në faqen e internetit

www.portaleimmigrazione.it mund të kërkosht:

- informacione të përgjithshme mbi procedurën;
- adresat e Bashkive dhe të Patronatëve të autorizuar;
- adresat e zyrave të postave me *Sportello Amico*;
- ecurinë e praktikës duke përdorur, në një faqe të mbrojtur, *userid*-in dhe *password*-in e specifikuar në kuponin e lëshuar nga posta në momentin e paraqitjes së kërkesës.

Po ashtu mund të telefonosh në këto numra:

800.309.309 (falas) i administruar në bashkëpunim me Anci-n.

Për informacione të përgjithshme, për adresat e bashkive dhe të patronateve të kualifikuara.

Në shërbim, çdo ditë, 24 orë në ditë, në italisht, anglisht, spanjisht, arabisht dhe frëngjisht.

803.160 (falas) i Postave Italiane.

Për të njohur adresën e zyrave të postës me *Sportello Amico*.

Nga e hëna deri të shtunën, me orar 8°°-20°°.

848.855.888 (tarifë urbane), për informacione mbi ecurinë e praktikës tënde.

Nga e hëna deri të premtën, me orar 8°°-20°°.

Lejeqëndrimet në Kuesturë

Marrëveshja midis Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe shoqërisë së Postave Italiane përcakton që Kuestura mund të pranojë kërkesat e kryera për të lëshuar **9 lloje lejeqëndrimesh** për:

- ✓ Kura mjekësore
- ✓ Gara sportive
- ✓ Pushime pune
- ✓ Arsye humanitare
- ✓ Strehim politik (kërkesë dhe njohje)
- ✓ Moshë të mitur
- ✓ Arsye drejtësie
- ✓ Kërkesë për statusin e apolidit (lëshim)
- ✓ Integrimin e të miturit

Azhurnime mbi lejeqëndrimet nën 3 muaj

Nga 2 qershori 2007 të huajt që dësherojnë të qëndrojnë në Itali për një periudhë më të shkurtër se 3 muaj, për **turizëm, biznes, vizitë, ose studim nuk duhet të kërkojnë lejeqëndrim.**

Ky azhurnim ka marrë formë në bazë të **ligjit n. 68 i 28 majit 2007**, i botuar në Gazetën Zyrtare të 1 qershorit 2007. Sipas udhëzimeve të reja, nënshtetasit e huaj që dësherojnë të qëndrojnë në Itali për një periudhë më të shkurtër se 3 muaj, duhet vetëm të deklarojnë praninë e tyre në territorin italian *si parashikohet nga Dekreti i Ministrisë së Punëve të Brendshme të 26 korrikut 2007 (të publikuar në Gazetën Zyrtare të 6 gushtit 2007, n. 181)*. Zbatimi i këtij detyrimi vërtetohet nga vula Schengen e vendosur nga Policia Kufitare në dokumentin e udhëtimit, nëse i huaji vjen nga një shtet që nuk ka nënshkruar Marrëveshjen Schengen. Por, nëse i huaji vjen nga një shtet që ka nënshkruar Marrëveshjen Schengen, deklarata e pranisë në Itali mund të bëhet në Kuesturë brenda 8 ditësh nga data e hyrjes. Nëse banon në një strukturë hoteli/pritjeje ky



detyrim duhet vërtetuar duke i dhënë të huajt kopjen e deklaratës së parashikuar nga ligji për këto raste.

Është e rëndësishme që qëndrimi në Itali të mos zgjasë më shumë se 3 muaj ose që të mos tejkalohej periodha minimale e përcaktuar nga viza e hyrjes (kur kjo nevojitet) e të respektohen kushtet e hyrjes.

Hyrja dhe qëndrimi në Itali për më shumë se 3 muaj

Të huajt që dësherojnë të qëndrojnë në Itali duhet të kërkojnë lejeqëndrim.

Ata që vijnë në Itali për herë të parë duhet të kërkojnë lejeqëndrimin brenda **8 ditësh**. Ata që ndodhen në Itali me lejeqëndrim të cilit po i mbaron afati, duhet të bëjnë kërkesë për përtëritje brenda afateve të përcaktuara si më poshtë por sidoqoftë brenda **60 ditësh** pas mbarimit të afatit.

Për **lëshimin** e lejeqëndrimit janë të nevojshëm:

- formulari i kërkesës;
- pasaporta e vlefshme (ose një dokument tjetër i barasvlershëm) me vizë hyrjeje nëse nevojitet;
- një fotokopje e këtij dokumenti;
- 4 fotografi pasaporte, të njëjta dhe të bëra kohët e fundit;
- një pullë-taksë prej 14,62 euro;
- dokumentacioni i përshtatshëm për llojin e lejeqëndrimit të nevojshëm.

NË ITALI SIPAS RREGULLAVE

Kërkesa për përtëritjen e lejeqëndrimit duhet të dorëzohet të paktën:

- 90 ditë para mbarimit të afatit, për lejeqëndrimet 2-vjeçare;
- 60 ditë para mbarimit të afatit për lejeqëndrimet 1-vjeçare;
- 30 ditë para mbarimit të afatit për të gjitha rastet e tjera.

Afati i lejeqëndrimit është i njëjtë me atë të vizës së hyrjes:

- maksimumi **9 muaj** për punë stinore;
- deri në **një vit**, për punë të nënvarur me kontratë me kohë të kufizuar, për ndjekjen e një kursi studimi ose formimi profesional;
- deri në **dy vjet** për punë të pavarur, për punë të nënvarur me kohë të pakufizuar dhe për bashkimet familjare.

Nënshtetasit e Bashkimit Evropian (BE)

Nëse je nënshtetas i Bashkimit Evropian nuk është e nevojshme të kërkesësh kartën e qëndrimit. Nëse dëshëron të qëndrosh në Itali më shumë se 3 muaj duhet t'i drejtohesh zyrës së gjendjes civile të bashkisë ku banon dhe të kërkesësh të regjistrohesh si edhe lëshimin e vërtetimit përkatës.

Të afërmit e nënshtetasve të Bashkimit Evropian

Nëse je i huaj, i afërm i një nënshtetasi italian ose i një nënshtetasi të Bashkimit Evropian, dhe ke hyrë në mënyrë të rregullt në Itali, mund të kërkesësh kartën e qëndrimit si i afërm të një nënshtetasi BE në Kuesturë ose në zyrën e postës.

Në këtë rast duhet të plotësosh formularët e kërkesës dhe të bashkëngjitesh:

- ✓ fotokopjen e pasaportës ose të një dokumenti të barasvlershëm, të pajisur me vizë kur kjo është e nevojshme;
- ✓ 4 fotografi pasaporte;
- ✓ fotokopjen e dokumentit që vërteton lidhjen farefisnore, e nëse nevojitet, një dokument që vërteton të qenit në ngarkim;
- ✓ fotokopjen e kërkesës së regjistrimit në zyrën e gjendjes civile të të afërmit nënshtetas BE.

Konsiderohen të afërm të nënshtetasit BE që mund të bëjnë kërkesë për këtë lloj karte:

- bashkëshortit;
- pasardhësit e drejtpërdrejtë nën moshën 21 vjeç ose në ngarkim si edhe ata të bashkëshortit;
- paraardhësit e drejtpërdrejtë në ngarkim si edhe ata të bashkëshortit.

Lejeqëndrimi BE për afat të gjatë

1. Kush mund ta kërkojë

Mund të kërkesësh lejeqëndrim për qëndrim afatgjatë (**Permesso di Soggiorno CE per Soggiornanti di Lungo Periodo - S.L.P.**), më parë e quajtur Kartë Qëndrimi, për vete dhe për të afërmit e tu nëse:

- ke një lejeqëndrim të rregullt në Itali prej të paktën 5 vjetësh;
- ke të ardhura minimale baraz me gjysmën e shumës së çekut social. Nëse bën kërkesë edhe për të afërmit e tu, të ardhurat duhet të jenë si në tabelën që vijon:

NUMRI I FAMILJARËVE (përfshirë kërkuenin)	TË ARDHURAT VJETORE MINIMALE
1-2 (një -dy)	baraz me çekun social (për 2007-n është 5.061,68 euro)
3-4 (tre ose katër)	baraz me dyfishin e çekut social
5 (pesë dhe më shumë)	baraz me trefishin e çekut social



Të afërmit për të cilët mund të kërkohsh lejeqëndrim BE (permesso di soggiorno CE) janë po ata për të cilët mund të kërkohsh bashkim familjar (bashkëshorti, fëmijët e mitur, edhe të bashkëshortit, ose të lindur jashtë martesë, fëmijë në moshë madhore në ngarkim që nuk mund tu përgjigjen nevojave të domosdoshme të jetesës për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore; prindërit në ngarkim).

Nëse bën kërkesë për lejeqëndrim BE edhe për familjarët e tu duhet të bashkëngjithësh fotokopjen e çertifikatës së përshtatshmërisë të banesës.

2. Si kërkohet

Duhet të paraqitesh në një zyrë të postës ku gjenden falas formularët e nevojshëm për të dërguar kërkesën (**kit con banda gialla**-paketa me shirit të verdhë).

Përpilimi i kërkesës duhet bërë duke ndjekur udhëzimet e paketës (kit) dhe të skedës "Lëshimi - Përtëritja e Lejeqëndrimit".

Bashkë me formularin (të plotësuar dhe të nënshkruar) duhet të paraqesësh:

- ✓ fotokopjen e të gjithë pasaportës (ose të ndonjë dokumenti tjetër të barasvlershëm);
 - ✓ fotokopjen e deklaratës së të ardhurave (Modello Unico, CUD,... të vitit të kaluar).
- Bashkëpunëtorëve shtëpiakë (colf/badanti)

u kërkohet të paraqesin *bolletino INPS* ose listën e përmbledhur të kontributeve të sigurimeve shoqërore (*estratto contributivo analitico*) të lëshuar nga INPS-i;

- ✓ çertifikatën e regjistrit gjyqësor (*casellario giudiziale*) dhe çertifikatën e regjistrimit të procedurave penale në ngarkim (*iscrizioni relative ai procedimenti penali*) që duhen kërkuar pranë Zyres së Regjistrimit të Gjykatës (*Ufficio Casellario del Tribunale*);
- ✓ kopjen e faturave të rrogave (*busta paga*) të vitit në zhvillim;
- ✓ çertifikatat e vendbanimit (*residenza*) dhe e gjendjes familjare;
- ✓ buletinin postar të pagesës së lejeqëndrimit elektronik (27,50 euro);
- ✓ pullë-taksë prej 14,62 euro.

KINI PARASYSH QË

Lejeqëndrimi BE për qëndrim afatgjatë:

- ka afat të pakufizuar;
- është dokument identifikimi personal 5-vjeçar që mund të përtërihet duke dorëzuar fotografi të reja;
- nuk mund t'i lëshohet shtetasit të huaj që është i rrezikshëm për sigurinë e Shtetit dhe rendin publik;
- nuk mund të kërkohet nga personat që kanë lejeqëndrim për studime, formim profesional, mbrojtje të përkohshme, motive humanitare, **kërkesë për strehim politik nëse statusi nuk është njohur ende**, apo nga personat që kanë lejeqëndrim për kohë të shkurtër.

Lejeqëndrimi BE për qëndrim afatgjatë për bashkëshort/e bashkëjetues/e

Si kërkohet

Nëse je bashkëshort/e i/e një të huaji/e që ka lejeqëndrim BE ose i/e një të huaji/e që ka bërë kërkesë për këtë lloj lejeqëndrimi, mund të kërkohsh lejeqëndrim BE për arsye familjare **duke plotësuar formularin 1 (formulari 2 duhet të plotësohet nëse edhe ti ke të ardhurat e tua), me pullë-taksë prej 14,62 euro.**

Formularit të përpiluar dhe të nënshkruar i duhen bashkëngjitur: ▶

NË ITALI SIPAS RREGULLAVE

- ✓ fotokopja e të gjithë pasaportës (ose të ndonjë dokumenti tjetër të barasvlershëm);
- ✓ fotokopja e deklaratës së të ardhurave të bashkëshortit (*Modello Unico, CUD,...* të vitit të kaluar) ose vetjake (nëse ke të ardhura). Bashkëpunëtorëve shtëpiakë (*colf/badanti*) u kërkohet të paraqesin *bolletino INPS* ose listën e përmblodhur të kontributeve të sigurimeve shoqërore (*estratto contributivo analitico*) të lëshuar nga INPS-i;
- ✓ çertifikata e regjistrit gjyqësor (*casellario giudiziale*) dhe çertifikata e regjistrimit të procedurave penale në ngarkim (*iscrizioni relative ai procedimenti penali*) që duhen kërkuar në Zyrën e Regjistrit të Gjykatës (*Ufficio Casellario del Tribunale*);
- ✓ fotokopja e dokumentacionit të gjendjes civile që vërteton lidhjen martesore. Nëse është lëshuar jashtë shtetit, çertifikata duhet të përkthehet, legalizohet nga përfaqësia diplomatike ose konsullore italiane;
- ✓ fotokopja e çertifikatës së përshtatshmërisë së banesës;
- ✓ buletin postar të pagesës së lejeqëndrimit elektronik (27,50 euro).

Lejeqëndrimi BE për qëndrim afatgjatë për fëmijët e mitur mbi 14 vjeç

Si kërkohet

Nëse je fëmijë i mitur mbi 14 vjeç i një të huaji me lejeqëndrim BE për qëndrim afatgjatë apo që ka bërë kërkesë për lejeqëndrim BE për qëndrim afatgjatë dhe me të cilin bashkëjeton, duhet të përpilosh dhe të nënshkruash *formularin 1* duke i bashëngjitur një *pullë-taksë 14,62 euro* për të kërkuar lejeqëndrimin BE për qëndrim afatgjatë për arsye familjare.

Formularit të përpiluar dhe të nënshkruar i duhen bashkëngjitur:

- ✓ fotokopja e të gjithë pasaportës (ose e të një dokumenti tjetër të barasvlershëm);
- ✓ fotokopja e dokumentacionit të gjendjes civile që vërteton lidhjen prindërore me fëmijën e mitur. Nëse ky dokumentacion është lëshuar jashtë shtetit duhet të përkthehet, të noterizohet dhe të legalizohet nga përfaqësia diplomatike ose konsullore italiane (dokumentet nuk nevojiten nëse fëmija i mitur ka hyrë në Itali me vizë për bashkim familjar);

- ✓ fotokopja e çertifikatës së përshtatshmërisë së strehimit;
- ✓ buletin postar të pagesës së lejeqëndrimit elektronik (27,50 euro).

Lejeqëndrimi BE për qëndrim afatgjatë për prindërit bashkëjetues në ngarkim

Si kërkohet

Nëse je prind bashkëjetues i një nënshtetasi të huaj që ka lejeqëndrim BE për qëndrim afatgjatë ose i një të huaji që ka bërë kërkesë lejeqëndrimi BE për qëndrim afatgjatë, mund të kërkosh të të jepet ky lloj lejeqëndrimi për arsye familjare duke plotësuar *formularin 1* të paketës me shirit të verdhë (*kit con banda gialla*) të formularëve, me *pullë-taksë 14,62 euro*.

Bashkë me formularin duhet të paraqesësh:

- ✓ fotokopjen e të gjithë pasaportës (ose të ndonjë dokumenti tjetër të barasvlershëm);
 - ✓ fotokopjen e deklaratës së të ardhurave (*Modello Unico, CUD,...* të vitit të kaluar). Bashkëpunëtorëve shtëpiakë (*colf/badanti*) u kërkohet të paraqesin *bolletino INPS* ose listën e përmblodhur të kontributeve të sigurimeve shoqërore (*estratto contributivo analitico*) të lëshuar nga INPS-i;
 - ✓ çertifikatën e regjistrit gjyqësor (*casellario giudiziale*) dhe çertifikatën e regjistrimit të procedurave penale në ngarkim (*iscrizioni relative ai procedimenti penali*) që duhen kërkuar në Zyrën e Regjistrit të Gjykatës (*Ufficio Casellario del Tribunale*);
 - ✓ fotokopjen e dokumentacionit të gjendjes civile që vërteton lidhjen farefisnore. Nëse është lëshuar jashtë shtetit, çertifikata duhet të përkthehet e të legalizohet nga përfaqësia diplomatike ose konsullore italiane;
 - ✓ fotokopjen e çertifikatës së përshtatshmërisë së banesës;
 - ✓ deklaratën personale (*autocertificazione*) mbi rezidencën dhe gjendjen familjare;
 - ✓ buletin postar të pagesës së lejeqëndrimit elektronik (27,50 euro).
- Për ç'do kërkesë lejeqëndrimi BE për afat të gjatë, që do ti dorëzohet nëpunësit të zyrës së postës, duhen derdhur 30 euro.

FËMIJËT E MITUR

■ Fëmijët e mitur nën 14 vjeç nuk duhet të bëjnë një kërkesë me vete nga ajo e prindit (ose e prindërve) me të cilët jetojnë. Në këtë

rast prindi kur bën kërkesë për lejeqëndrim, apo për lejeqëndrim BE për qëndrim afatgjatë duhet të kërkojë regjistrimin e fëmijës nën 14 vjeç në dokumentin e vet, duke plotësuar pjesën përkatëse të formularit 1.

■ Pasi kanë mbushur moshën 14 vjeçare, të miturve të regjistruar në lejeqëndrimin ose në kartën e qëndrimit të njërit prej prindërve, u lëshohet një lejeqëndrim për arsye familjare deri në moshën madhore, ose lejeqëndrimi BE.

■ Lejeqëndrimi për arsye familjare jep mundësinë të shfrytëzohet asistenca sociale e shëndetësore; lejon regjistrimin në kurset e

studimit ose të formimit profesional; punësimin e pavarur ose të nënvarur vetëm nëse e lejon moshën.

■ Lejeqëndrimi për arsye familjare ka të njëjtën kohëzgjatje si lejeqëndrimi i të afërmit të huaj që ka marrë autorizimin “*nullaosta*” për bashkimin familjar dhe është i përtëritshëm si ky i fundit.

■ Pas mbushjes së moshës madhore, të huajit që ka një lejeqëndrim për arsye familjare i lëshohet një lejeqëndrim për arsye studimi, për punësim, ose për punë sipas aktivitetit që kryen. ●

Kërkesa për strehim politik

1. Mund të kërkoj statusin e refugjatit nëse:

në vendin tënd je persekutuar drejtpërdrejt dhe personalisht për arsye race, feje, kombësie, pjesëmarrjeje në grupe të ndryshme shoqërore ose për bindjet e tua politike, apo nëse ke arsye reale dhe të dokumentuara për të menduar se mund të jesh viktimë përndjekësh nëse kthehesh në atdhe (në bazë të Konventës së Gjenevës).

2. Nuk mund të kërkoj statusin e refugjatit në Itali nëse:

■ të është njohur statusi i refugjatit në një shtet tjetër;

■ vjen nga një vend i ndryshëm nga i yti, që ka nënshkruar Konventën e Gjenevës dhe në të cilin ke qëndruar për një kohë të mjaftueshme por pa kërkuar njohjen e statusit të refugjatit;

■ je dënuar në Itali për krime kundër autoritetit ose sigurisë së shtetit, kundër rendit publik, ose për krime si skllavërimi, vjedhja, rrëmbimi, rrënimi dhe plaçkitja, ose për aktivitete të lidhura me shitjen ose trafikun e paligjshëm të armëve o të substancave narkotike, e më së fundi për marrëdhënie me organizatat mafioze ose terroriste;



■ nëse ke kryer krime lufte ose kundër paqes dhe njerëzimit.

3. Ku kërkohet

✓ Pranë zyrës së Policisë Kufitare, në momentin e hyrjes në Itali ose

✓ pranë Zyrës së Imigracionit të Kuesturës kompetente të territorit, nëse në pikëhyrje nuk ka një Zyrë të Policisë Kufitare

4. Si kërkohet

Mund të paraqesësh kërkesën pranë Zyrës së Policisë, që do të të japë formularët e posaçëm ku duhet:

■ të shpjegosh arsyet për të cilat kërkon statusin e refugjatit

■ të japësh çdo informacion ose dokumentacion në dispozicion të mbështetje të arsyeve për të cilat bën kërkesën ▶

NË ITALI SIPAS RREGULLAVE

■ duhet të bashkëngjitesh kopje të një dokumenti identifikimi (pasaportë, letërnjoftim, etj) personal të vlefshëm nëse e ke, ose duhet t'i japësh të dhënat personale policisë, duke specifikuar adresën në të cilën mund të të dërgojnë njoftimet e duhura.

Kuestura do të të lëshojë një kopje të kërkesës dhe të dokumentacionit të paraqitur e do të të bëjë fotografitë e të marrë shenjat e gishtërinjve.

5. Kush vendos për kërkesën tënde

Kërkesa e plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm, do t'i dërgohet menjëherë nga Kuestura Komisionit Territorial për Njohjen e Statusit të Refugjatit kompetent që do të vendosë nëse do të të njihet statusi apo jo. Në Itali ka 7 të tilla (Gorizia, Milano, Roma, Foggia, Siracusa, Crotone dhe Trapani). Kuestura do të të dërgojë fletëftesën me datën në të cilën do të paraqitesh në Komision në adresën që ke specifikuar kur ke bërë kërkesën.

Është e rëndësishme që Kuesturës ti bësh të njohur çdo ndryshim adrese ku të të dërgojë të gjitha njoftimet që mund të të interesojnë. Ki parasysh që seanca që do të mbahet në datën në të cilën do të paraqitesh është shumë e rëndësishme për të shpjeguar mirë situatën tënde dhe për të përshkruar si duhet frikën e persekutimit; prandaj nëse nuk paraqitesh në seancë, Komisioni mund të vendosë duke u bazuar vetëm në shqyrtimin e dokumentacionit të disponueshëm pa dëshminë tënde të drejtpërdrejtë.

6. Cilat janë vendimet që mund të marrë Komisioni

Komisioni Territorial, brenda tre ditësh pas datës së seancës, merr një prej vendimeve të mëposhtme:

- ✓ njeh statusin e refugjatit;
- ✓ hedh poshtë kërkesën, por edhe nëse i vlerëson të pamjaftueshme arsyet për të kërkuara statusin e refugjatit, mund të vlerësojë në mënyrë independente rrezikshmërinë e riatdhesimit dhe t'i kërkojë Kuestorit të të lëshojë një lejeqëndrim për

arsye humanitare. Ky tip lejeqëndrimi është një-vjeçar, i përtëritshëm dhe të lejon të punosh;

✓ hedh poshtë kërkesën, e në këtë rast Kuestori do të të kërkojë të largohesh nga territori italian.

7. Nëse nuk di italisht

Nëse nuk di italisht mund të kërkossh ndihmën e një përkthyesi ose të një ndërmjetësi kulturor për të pëpiluar dhe hartuar, nëse është e mundur, në gjuhën tënde ose në një nga gjuhët më të njohura (anglisht, frëngjisht, spanjisht, arabisht) formularin informativ, dhe deklaratat që kanë të bëjnë me kërkesën.

8. Çfarë ndodh pas paraqitjes së kërkesës

■ Nëse Autoritetet e Policisë kanë verifikuar se *dokumentacioni i paraqitur është i rregullt*, lëshohet nga Kuestori i provincës ku është paraqitur kërkesa, një lejeqëndrim 3-mujor, i përtëritshëm deri në ditën e marrjes së vendimit nga ana e Komisionit Territorial përkatës.

■ Nëse ke mbërritur në Itali pa *asnjë lloj dokumenti që vërteton kombësinë dhe të dhënat personale*, ose nëse kërkesa për statusin e refugjatit bazohet në elemente që duhen verifikuar do të strehohesh për një periudhë prej **së shumti 20 ditësh në një Qendër Identifikimi**. Nëse brenda kësaj periudhe, Komisioni Territorial nuk do të ketë marrë akoma vendim mbi kërkesën tënde, mund të largohesh nga qendra dhe do të të lëshohet një lejeqëndrim 3-mujor, i përtëritshëm deri në përfundimin e praktikës.

Nëse nuk ke mundësi të përballosh vetë shpenzimet e jetesës, mund t'i kërkossh Prefekturës përkatëse, nëpërmjet Zyrës së Policisë ku ke paraqitur kërkesën, të të strehojë gjatë gjithë periudhës së shqyrtimit të kërkesës për strehim politik në njësitë e posaçme për strehim të bashkisë.

9. Ki parasysh se në Qendër e Identifikimit

✓ do të të sigurohen kurat mjekësore urgjente;

✓ do të mund të presësh pa kushtëzime të veçante vizitat e të afërmve, të avokatit tënd, të UNHCR-së (Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët) dhe të organizatave ose enteve për mbrojtjen e refugjatëve të njohura nga Ministria e Punëve të Brendshme;

✓ nuk je i detyruar të qëndrosh brenda Qendrës, përveç gjatë orëve të natës, nëse respekton kushtet e përcaktuara nga rregullorja e entit administrues të saj. Përveç kësaj mund edhe të kërkosh të largohesh për kohë të gjatë, përtej orareve të përcaktuara në rregullore për arsye të veçanta (familjare, shëndeti etj), me autorizim paraprak të nënpunësit kompetent të qendrës;

✓ largimi i zgjatur, i paautorizuar ose pa arsye të konsideruara të mjaftueshme nga qendra, kuptohet si heqje dorë nga kërkesa për njohjen e statusit të refugjatit.

10. Si mund të kërkosh rishqyrtimin e çështjes

Nëse strehohesh në një Qendër Identifikimi, mund t'i paraqesësh Presidentit të Komisionit Territorial, brenda 5 ditësh nga marrja e vendimit negativ, një **lutje për rishqyrtimin** e kërkesës tënde, bazuar në elemente të verifikuar pas vendimit të komisionit ose në fakte të mëparshme që nuk janë vënë në dukje gjatë seancës së parë. Vendimi mbi rishqyrtimin e kërkesës do të merret brenda 15 ditësh.

Sidoqoftë, mund të paraqesësh, brenda 15 ditësh nga njoftimi i vendimit të Komisionit, një **apel pranë Gjykatës së shkallës së parë** të territorit (nëse nuk je në Itali apeli mund të kryhet nëpërmjet përfaqësuesit diplomatike).

Në të dyja rastet mund t'i kërkosh Prefektit të provincës ku banon të autorizojë qëndrimin tënd në Itali deri në ditën e vendimit të marrë mbi apelin. Vendimi i prefektit do të të bëhet i njohur brenda 5 ditësh nga kërkesa, dhe në rast pranimit, do të të njoftojë edhe mbi kushtet e qëndrimit në Itali.

11. Çfarë ndodh në rast njohjeje të statusit të refugjatit

■ Komisioni, kur të të njohë të drejtën e statusit të refugjatit, do të të lëshojë një fletë-vërtetim.

■ Së bashku me këtë dokument, Kuestura përkatëse do të të dorëzojë edhe një dokument personal (me po të njëjtin afat të lejeqëndrimit) që do të të lejojë, nëse dëshëron, të shkosh jashtë shtetit dhe të rikthehesh në Itali.

■ Për të marrë dokumentet e identifikimit duhet t'i drejtohesh Bashkisë ku ke regjistruar vendbanimin.

■ Do të të njihet një lejeqëndrim dyvjeçar.

■ Do të kesh të gjitha të drejtat dhe do t'i përgjigjesh të gjitha detyrimeve që kanë nënshtetësit italian, me përjashtim të atyre për të cilat nevojitet nënshtetësia italiane (p.sh. e drejta e votimit, pjesëmarrja në konkurse për punësim në administratën shtetërore etj).

■ Nëse të nevojiten dokumente ose çertifikata nga vendi yt për të ushtruar një të drejtë çfarëdo në Itali, autoritetet italiane do të angazhohen për të t'i siguruar ose do të t'i zëvendësojnë me akte italiane me të njëjtën vlerë të atyre të vendit tënd.

■ Nuk mund të kthehesh në vendin tënd për asnjë arsye. Kjo rrethanë mund të shkaktojë heqjen e statusit, me qenë se shpreh dëshirën për të rifituar mbrojtje prej shtetit tënd. Po ashtu, edhe kërkesa e pasaportës pranë përfaqësive diplomatike të vendit tënd në Itali do të kuptohet si shprehje e vullnetit për rifitim të mbrojtjes prej shtetit tënd.

■ Dokumenti personal që do të të dorëzojë Kuestura do të të japë mundësinë të shkosh jashtë shtetit pa vizë për një periudhë që nuk i tejkalon tre muajt. Nëse ke nevojë të qëndrosh jashtë shtetit për periudha më të gjata, p.sh. për arsye pune, duhet të kërkosh vizën pranë përfaqësive diplomatike të vendit ku dëshiron të shkosh, dhe të fillosh procedurën për "transferimin e kompetencave" në shtetin tjetër.

Bashkimi familjar



1. Kush mund të bëjë kërkesë

Nëse je nënshtrë i huaj me lejeqëndrim BE për qëndrim afatgjatë ose me lejeqëndrim për punë të nënvarur, të pavarur, strehim politik, studim, arsye familjare e arsye fetare, me kohëzgjatje prej të pakën një viti, mund të bësh kërkesë për tu bashkuar me të afërmit e tu më të ngushtë, në mënyrë që familja jote të jetë e bashkuar.

2. Familjarët për të cilët parashikohet bashkimi familjar

- ✓ bashkëshorti;
- ✓ fëmijët e tu të mitur, apo të bashkëshortit edhe nëse kanë lindur jashtë martesë (pra kur prindërit janë të pamartuar ose ligjërisht të ndarë), me kusht që prindi tjetër, në rast se jeton, të japë pëlqimin e tij;
- ✓ fëmijët në moshë madhore në ngarkim, nëse nuk mund të përballojnë shpenzimet e tyre për shkak të gjendjes shëndetësore që pengon përgjithmonë plotësimin e nevojave elementare;
- ✓ prindërit në ngarkim që nuk kanë mbështetje familjare të përshtatshme kudo që të jenë.

3. Aktivitetet e Sportelit Unik

- Nëse mendon se plotëson kushtet e sipërpërmendura, mund t'i dorëzosh ose t'i dërgosh Sportelit Unik kompetent formularin e posaçëm për kërkesën e autorizimit "nullaosta", së bashku me kopjen e pasaportës, të lejeqëndrimit si edhe dokumentacionin mbi përshtatshmërinë e banesës dhe mbi të ardhurat minimale të nevojshme.
- Familjari për të cilin kërkon bashkimin familjar duhet t'i paraqesë autoritetit konsullor italian në vendin ku jeton, dokumentacionin që provon marrëdhëniet farefisnore, moshën e mitur ose gjendjen shëndetësore.

- Sporteli Unik lëshon një kupon të kërkesës dhe të dokumentacionit të paraqitur.

■ Pasi është verifikuar plotësimi i kushteve të sipërpërmendura, brenda 90 ditësh nga marrja e kërkesës, Sporteli Unik të lëshon autorizimin "nullaosta", ose vendimin e refuzimit, duke ia përcjellë edhe autoritetit konsullor.

■ Nëse Sporteli Unik nuk ka lëshuar ende autorizimin "nullaosta", pas 90 ditësh nga data e kërkesës, personi që dëshëron të bashkohet me të afërmin e tij në Itali duhet të paraqesë, në përfaqësinë diplomatike o konsullore italiane, kopjen e kuponit dhe dokumentacionin përkatës, që i afërmi ka dorëzuar në Sportelin Unik, për të marrë vizën e hyrjes.

■ Brenda 8 ditësh nga hyrja në Itali i afërmi në fjalë duhet të paraqitet pranë Sportelit Unik që ka lëshuar autorizimin "nullaosta", që përpilon e dorëzon formularin e kërkesës së lejeqëndrimit, përndryshe do të konsiderohet i parregullt në territorin italian.

■ Lejeqëndrimi për arsye familjare lejon të kryhet punë e nënvarur ose e pavarur, regjistrimin në kurse shkollore dhe shfrytëzimin e Shërbimit Shëndetësor Italian.

4. Procedura për të afërmit që merrni me vete

Për të favorizuar mirëkuptimin dhe bashkimin në familje, nëse ke një vizë hyrjeje për punë të nënvarur me kontratë pune të paktën një vjeçare, për punë të pavarur të vazhdueshme, për studime, ose për arsye fetare, i lejohet hyrja edhe të afërmeve që merrni me vete dhe me të cilët është e mundur të realizohet bashkimi familjar.

Për të afërmit në fjalë zbatohet e njëjta praktikë e parashikuar për bashkimin familjar dhe nevojitet i njëjti dokumentacion.

Për kërkesën e autorizimit "nullaosta" mund të shfrytëzosh një person (i ngarkuar me prokurë speciale.

Dokumentacionit të mësipërm duhet t'i bashkëngjitet:

- ✓ një fotokopje e një dokumenti identifikimi të të ngarkuarit;
- ✓ prokura e nënshkruar (para nënpunësit të konsullatës) nga i huaji që ka marrë vizën për arsyet e sipërpërmendura, për nënshtetasin italian ose të huaj me lejeqëndrim të rregullt në Itali që është ngarkuar të kërkojë autorizimin "nullaosta" për të afërmit që do të marrësh me vete (formulari i duhur gjendet pranë përfaqësive diplomatiko-konsullore).

I afërmi i huaj i një nënshtetasi italian apo i BE-së nuk duhet të kërkojë autorizim "nullaosta" në Sportelin Unik, por duhet të kërkojë vizën direkt në ambasadë.



5. Lëshimi i lejeqëndrimit

■ Pas vajtjes në Sportelin Unik, i afërmi i bashkuar me ju ose që mund të keni marrë me vete duhet të paraqitet në një zyrë poste për të dërguar kërkesën për lejeqëndrim. Zyra e Postës lëshon një kupon me dy kode identifikues (userid dhe password) nëpërmjet të cilëve i interesuari mund të njohë ecurinë e praktikës duke u lidhur me faqen e internetit www.portaleimmigrazione.it.

■ Kuestura do t'a njoftojë në adresën e përcaktuar në kërkesë apo me telefon, mbi datën e takimit në zyrat e saj për të kryer marrjen e shenjave të gishtave e të fotografive dhe më pas do të njoftojë sërish për dorëzimin e lejeqëndrimit. ●

Të miturit e huaj

Të miturit e huaj, edhe nëse kanë hyrë në Itali si klandestinë, kanë të gjitha të drejtat e garantuara nga Konventa e New Yorkut mbi të drejtat e të vegjëlve të 1989, ku gjithashtu, është vendosur që të gjitha vendimet në lidhje me të miturit duhet të kenë si prioritet "interesin superior të të miturit".

Organi i caktuar nga ligji për vëzhgimin e konditave të qëndrimit të të miturve të huaj, të pranuar përkohësisht në territorin italian, dhe që koordinon aktivitetet e administratave të interesuara është Komiteti për të miturit e huaj, i inkuadruar në Ministrinë e Solidaritetit Shoqëror.

Të miturit që ndodhen në Itali mund të jenë:

■ "të shoqëruar", që me vendim zyrtar janë nën kujdestarinë e të afërmeve deri në shkallën e tretë e me qëndrim të rregullt;

■ "të pashoqëruar", që ndodhen në Itali pa prindërit o të rritur të tjerë që kanë përgjegjësinë ligjore t'i ndihmojnë apo t'i përfaqësojnë.

1. Të drejtat e të miturve:

Edukimi shkollor

Të gjithë të miturit e huaj, edhe në mungesë të lejeqëndrimit, kanë të drejtë të regjistrohen në ç'do lloj shkolle apo nivel shkollor (jo vetëm në shkollën e detyrimit). Regjistrimi i tyre bëhet në të njëjtat mënyra e kushte si edhe për të miturit italian, e në ç'do periudhë të vitit. ▶

NË ITALI SIPAS RREGULLAVE

Të miturit që duhet të përfundojnë shkollën e detyrimit regjistrohen nga prindërit ose tutorët në klasën që i përket moshës përveç rasteve kur trupi mësimor vendos regjistrimin në një klasë tjetër në bazë të disa kritereve të veçanta si:

- programi mësimor në vendin ku janë kryer studimet e mëparshme;
- verifikimi i njohurive, aftësive dhe nivelit përgatitor të nxënësit;
- dëftesat e studimeve të përfunduara nga nxënësi.

Kurat mjekësore

Të miturit e huaj me lejeqëndrim (për arsye të moshës, nën kujdestari, për arsye familjare, për përkrahje sociale, për kërkesë strehimi politik o për strehim politik) janë të detyruar të regjistrohen nga tutorët e tyre në Sistemin Sanitar Kombëtar (S.S.N.). Pra, kanë të drejtë të plotë të shfrytëzojnë të gjitha shërbimet shëndetësore që garanton sistemi ynë sanitar.

Për regjistrimin e të miturve në S.S.N. duhet vajtur në Qendrën Sanitare Lokale ASL (*Azienda Sanitaria Locale*) të zonës ku kanë vendbanimin (*residenza*) ose ku jetojnë (siç është e specifikuar në lejeqëndrim) të pajisur me:

- ✓ dokument identifikimi personal;
- ✓ kodin fiskal;
- ✓ lejeqëndrim;
- ✓ deklaratë personale të vendbanimit (*autocertificazione di residenza*) ose të banesës (konsiderohet banesë qendra e strehimit ku jeton prej të paktën tre muajsh)

Në momentin e regjistrimit mund të zgjidhet mjeku i familjes ose pediatri e të miturit.

Pas regjistrimit do t'ju lëshohet një dokument, "*Tesera sanitarie personale*" që jep të drejtën të shfrytëzoni falas ose me pagesën e një shume të caktuar (*Ticket sanitario*) – sipas krahinës – shërbimet që ndjekin: vizitat mjekësore të përgjithshme ose të specializuara, vizitat mjekësore në shtëpi, shtrimin në spital, vaksinimet,

analizat e gjakut, radiografitë, ekografitë, ilaçet, asistencën rihabilituese dhe për protesta.

Të miturit e huaj pa lejeqëndrim nuk mund të regjistrohen në S.S.N., por sidoqoftë kanë të drejtë të shfrytëzojnë kurat, në ambulator ose në spital, të domosdoshme, të vazhdueshme apo urgjente për sëmundje, aksidente apo për programe mjeksore parandaluese të sëmundjeve. Sidoqoftë, do të garantohen shërbimet e mëposhtme:

- tutela sociale e shtatzanisë dhe e maternitetit;
- tutela e shëndetit të të miturit;
- vaksinimi sipas normave ligjore apo sipas fushatave për mbrojtjen kolektive paraprake të autorizuar nga Krahinat (*Regione*);
- masat ndërkombëtare për parandalimin e sëmundjeve;
- parandalimi, diagnoza dhe kurimi i sëmundjeve infektive.

Punësimi

Të miturve të huaj u aplikohen të njëjtat norma ligjore që vlejnë për të miturit italian për sa i përket punës (mund të fillojnë të punojnë pasi kanë mbushur 16 vjeç dhe pasi të kenë përfunduar shkollën e detyrimit).

2. Të miturve të huaj të pashoqëruar i njihen po ashtu edhe të drejtat si:

Përkrahja dhe asistenca

Të huajve të mitur të pashoqëruar u aplikohen të njëjtat norma të parashikuara nga ligjet italiane mbi përkrahjen e asistencën e të miturve. Aplikohen në mënyrë të veçantë normat lidhur me:

- ✓ vendosjen e të miturit të braktisur në një vend të sigurtë: i takon entit përkatës të zonës (zakonisht Bashkisë) përgjegjësia e gjetjes së vendbanimit;
- ✓ nisja e praktikës për kujdestarinë e të miturit, prindërit e të cilit nuk kanë objektivisht mundësinë të ushtrojnë të drejtat prindërore;
- ✓ kujdestaria e të miturit në një familje apo

në një komunitet kur gjendet përkohësisht në një ambient familjar të papërshtatshëm.

Nëse prindërit ose tutori i të miturit nuk kanë mundësinë të ushtrojnë të drejtat e detyrimet prindërore ndaj të miturit, kujdestaria vendoset nga Gjykata për të miturit (kujdestari gjyqësore) ose nga shërbimet sociale të Bashkisë. Në këtë rast i duhet kërkuar miratimi prindërore ose tutorit në fjalë dhe Gjykatësit Tutelar që merr vendim dhe ekzekuton kujdestarinë (gjyqësore).

Ç'do i mitur i huaj e i pashoqëruar që gjendet në territorin Italian duhet senjalizuar nga Autoritetet tek:

- ✓ **Prokura e Republikës pranë Gjykatës për të miturit, përveç rastit kur i mituri është i strehuar nga të afërm me lidhje farefinsore deri në shkallën e katërt, të përshtatshëm për kujdesjen e tij;**
- ✓ **Gjykatësi Tutelar, për nisjen e praktikës së kujdestarisë;**
- ✓ **Komititetit për të miturit e huaj, përveç rastit kur është bërë kërkesë për strehim politik.**

Mospërrjashtimi

Të miturit e huaj nuk mund të përjashtohen, përveçse për arsye që kanë të bëjnë me rendin publik apo sigurinë e shtetit (në këtë rast kompetenca i përket Gjykatës për të miturit).

Por, të miturit e huaj të pashoqëruar mund të riatdhesohen me anë të riatdhesimit nën mbikëqyrje, me objektiv garancinë e bashkimit të familjes.

Kjo masë merret vetëm nëse Komiteti për të miturit e huaj, pasi ka kryer një hetim specifik në vendin e të miturit, mendon se ky veprim bëhet në interes të të miturit.

Riatdhesimi nën mbikëqyrje realizohet nga Komiteti për të miturit e huaj dhe kryhet duke shoqëruar të miturin deri sa t'i ribesohet familjes apo autoriteteve të vendit të tij.

Ndryshe nga përrjashtimi, riatdhesimi nuk ndalon për 10 vjet rihyrjen në Itali.

Nëse i mituri mendon se riathdhesimi nuk është në interesin e tij, ai ka të drejtë të paraqesë apel, me anë të prindërore apo të tutorit, pranë Magjistraturës (Gjykata e shkallës së parë – TAR) për të anuluar vendimin.

Lejeqëndrimi

Të gjithë të miturit e huaj të pashoqëruar kanë të drejtë të marrin lejeqëndrim për moshë të mitur për vetë faktin e moshës.

Lejeqëndrimi për moshë të mitur mund të shndërrohet në lejeqëndrim për kujdestari në rast se, pas një vendimi **“pamundësi riatdhesimi”** të Komitetit për të miturit e huaj, të miturit jepen në kujdestari me vendim të Gjykatës për të miturit o me iniciativë të Shërbimeve Sociale që ekzekutohet nga Gjykatësi Tutelar.

Lejeqëndrimi për kujdestari i jep mundësinë të miturit të huaj të punojë në ato rase kur ligji italian e lejon për të miturit në përgjithësi. Kur i mituri mbush 18 vjeç, lejeqëndrimi mund të shndërrohet në lejeqëndrim për punë apo studim.



NË ITALI SIPAS RREGULLAVE

Të miturit nën kujdestarinë e një nënshitetasi të huaj me qëndrim të rregullt në Itali me të cilin bashkëjetojnë, regjistrohen në lejeqëndrimin e këtij të fundit deri sa të mbushin moshën 14 vjeçare, moment në të cilin mund të marrin një lejeqëndrim për arsye familjare.

Kërkesa, për lejeqëndrim për të miturin e pashoqëruar, duhet paraqitur nga personat që ushtrojnë autoritetin tutelar mbi të miturin, që mund të jetë:

- ✓ tutori, nëse është emëruar;
- ✓ përfaqësuesi ligjor (avokati) i institutit, komunitetit apo Entit lokal, nëse i mituri është caktuar në një institut o komunitet ose kur Enti lokal i jep asistencë;

Të kërkojnë strehim politik

Të miturit e huaj të pashoqëruar për të cilët mendohet se mund të persekutohen në vendin e tyre për arsye race, feje, kombësie, pjesmarrjeje në një grup shoqëror të caktuar apo për idetë politike, kanë të drejtë të paraqesin kërkesë për strehim politik me anë të tutorit.

Kërkesa për strehim shqyrtohet nga Komisioni Territorial për Njohjen e Statusit të Refugjatit kompetent. Nëse të miturit i njihet statusi i refugjatit, atij i lëshohet një lejeqëndrim për strehim politik; nëse kërkesa nuk pranohet, Komisioni ka autoritetin t'i kërkojë Kuestorit mundësinë e lëshimit të një lejeqëndrimi për arsye humanitare, nëse mendohet se riatdhesimi i të miturit mund të jetë i rrezikshëm apo thjesht i papërshtatshëm. Sioqoftë, i mituri ka të drejtë të paraqesë apel në Gjykatën e shkallës së parë kundër vendimit të Komisionit (SHIH UDHËZUESIN PËR STREHIM POLITIK).

3. Kur mbushet moshja 18 vjeçare

Mundësia që i mituri të qëndrojë në Itali me lejeqëndrim të rregullt, pasi ka mbushur moshën 18 vjeçare, varet nga lejeqëndrimi (për kujdestari o për arsye familjare) që ka pasur kur ishte i mitur e nga arsye të tjera.

Të miturit e pashoqëruar me lejeqëndrim për kujdestari mund t'a shndërrojnë në

lejeqëndrim për studim, për fillim pune, për punë të nënvarur e të pavarur kur mbushin moshën 18 vjeçare nëse:

- ✓ kanë hyrë në Itali të paktën tre vjet më parë, pra, para se të kenë mbushur moshën 15 vjeçare;
- ✓ kanë ndjekur për të paktën 2 vjet një projekt për integrim social e civil të organizuar nga një ent publik o privat i përfaqësuar në nivel kombëtar e i regjistruar në regjistrat e posaçëm e të parashikuar nga ligji;
- ✓ frekuentojnë kurse studimi o punojnë me pagesë e sipas kushteve që përshkruan ligji ose kanë një kontratë pune, edhe nëse nuk ka filluar ende punën.

Të miturit me lejeqëndrim për arsye familjare, mund t'a shndërrojnë në lejeqëndrim për studim, për punë të nënvarur ose të pavarur kur mbushin moshën 18 vjeçare.

Të miturit që kanë kryer një krim për të cilin janë burgosur para mbushjes së moshës madhore, nëse kanë marrë pjesë në një program asistence e integrimi social, në përfundim të dënimit, mund të marrin një lejeqëndrim për përkrahje sociale.

Lejeqëndrimi për përkrahje sociale mund të lëshohet nga Kuestori, me rekomandimin e shërbimeve të asistencës sociale të Bashkisë, edhe për të miturit të kërcënuar konkretisht nga situata të rënda shfrytëzimi e dhune (prostitucion, shfrytëzimi në punë, etj.) Lejeqëndrimi për përkrahje sociale lejon që të punohet dhe është i përtëritshëm. ●



Të huajt dhe zyra e gjendjes civile (anagrafe)

Regjistrimi i banorëve në zyrën e gjendjes civile është një masë për të cilën Kryetari i Bashkisë o i deleguari i tij vërtetojnë që vendbanimi yt i zakonshëm ndodhet në zonën e bashkisë.

1. Si mund të regjistrohesh

Për t'u regjistruar në zyrën e gjendjes civile duhet të jesh anëtar familjeje në moshë madhore. Duhet të paraqitesh personalisht në zyrën e gjendjes civile të bashkisë ku ndodhet banesa jote ku do të të dorëzohet një formular që duhet të përpilosh e nënshkruash.

Nëse keni fëmijë të mitur duhet të deklaroni edhe vendbanimin (*residenza*) e tyre. Kur të paraqiteni duhet të keni me vete:

- ✓ një lejeqëndrim me afat prej të paktën 3 muajsh;
- ✓ pasaportën ende të vlefshme ose një dokument të barasvlershëm;
- ✓ kodin fiskal;
- ✓ dokumentet që japin informacione që nuk ndodhen në pasaportë (çertifikata e lindjes, e martesës, e ndarjes, lidhjet farefisnore etj.). Këto dokumente duhet të jenë ose,
 - origjinale e të lëshuara nga shteti ku kanë ndodhur ngjarjet në fjalë, të përkthyer në italisht e të legalizuara; ose,
 - origjinale, të lëshuara nga autoritetet konsullore të vendit tënd, të pranishme në Itali, e me firmë të legalizueshme nga Prefektura përkatëse.

Nëse banon në një institut ose komunitet, të duhet një deklaratë vendbanimi (*residenza*) e lëshuar nga përgjegjësi i strukturës.

Regjistrimi i kërkesave në zyrën e gjendjes civile bëhet vetëm pasi nënpunësi i kësaj zyre, me anë të Policisë Bashkiake, do të ketë verifikuar që ti (dhe familja jote, në ke



bërë kërkesë edhe për të) jeton me të vërtetë në adresën e deklaruar. Në rast përgjigjeje pozitive, data e regjistrimit do të jetë ajo e paraqitjes së kërkesës në sportelin e zyrës së gjendjes civile të Bashkisë.

2. Duhet të dini që:

- regjistrimi në zyrën e gjendjes civile është i domosdoshëm për shumë veprime administrative si p.sh. lëshimi i patentës e regjistrimi në Sistemin Sanitar Kombëtar (*S.S.N.*).
- Të gjitha informacionet në pasaportë (emri, mbiemri, datëlindja, vendlindja, nënshtetësia) dhe në lejeqëndrim duhet të përputhen plotësisht.
- Regjistrimet, ndryshimet apo çregjistrimet do t'i transmetohen zyrtarisht Kuesturës kompetente për zonën.
- Nëse nuk je i regjistruar në zyrën e gjendjes civile, duhet t'i transmetosh ndryshimet e vendbanimit Kuesturës kompetente të zonës.
- Po ashtu je i detyruar të njoftosh (edhe në rast ndryshimi të vendbanimit o të adresës) Drejtorinë Tatimore të Bashkisë për taksën e tretjes së mbeturinave urbane. Formulari që duhet përpiluar do t'ju dorëzohet në sportelin e zyrës së gjendjes civile.
- Banesa e të huajt konsiderohet si vendbanim i zakonshëm edhe në rastin kur mund të vërtetosh se banon prej më shumë se 3 muajsh në një qendër strehimi. ▶

Brenda 60 ditësh nga ripërtëritja e lejeqëndrimit je i detyruar t'i përsëritësh nëpunësit të zyrës së gjendjes civile të Bashkisë deklaratën e banesës së zakonshme, duke i bashkëngjitur kopjen e lejeqëndrimit të ri. Në rast të kundërt mund të të heqin nga lista e banorëve të Bashkisë.

3. Ç'duhet bërë për të ndërruar vendbanimin (*residenza*)

Nëse dëshëron të shpërngulesh në një Bashki tjetër, duhet t'i paraqesësh një kërkesë Bashkisë, ku do të banosh, brenda 20 ditësh nga data e shpërnguljes.

Kur të bësh kërkesën duhet të paraqesësh:

- ✓ një dokument identiteti personal të vlefshëm;
- ✓ lejeqëndrimin ose kuponin e kërkesës së ripërtëritjes së lejeqëndrimit afati i të cilit ka mbaruar;
- ✓ patentën italiane dhe/ose kartën e qarkullimit të automjeteve që ke (nëse i ke).

Nëse kërkesa përfshin edhe familjen tënde, duhet të japësh edhe të dhënat e të gjithë anëtarëve. Në kërkesë duhet të japësh të dhënat e tua personale dhe adresën ku ke ndër mend të vendosesh. Nëse do të shpërngulesh në një familje tjetër do të nevojitet edhe miratimi i kryefamiljarit të saj.

4. Ç'duhet bërë për të ndërruar adresën

Nëse do thjesht të ndryshosh adresën brenda të njëjtës Bashki ku ke vendbanimin (*residenza*), duhet të paraqesësh kërkesë të posaçme në zyrën e gjendjes civile duke paraqitur po ashtu edhe një dokument identiteti të vlefshëm (pasaportë ose letërnjoftim), lejeqëndrimin e vlefshëm (edhe të gjithë anëtarëve të familjes që do të ndërrojnë adresën), patentën italiane dhe/ose kartën e qarkullimit të automjeteve që ke (nëse i ke).

5. Çregjistrimi nga zyra e gjendjes civile

Ki parasysh që të dhënat e tua do të hiqen nga regjistrat e zyrës së gjendjes civile të Bashkisë ku ke vendbanimin (*residenza*) e zakonshëm nëse:

- shpërngulesh me vendbanim (*residenza*) në një Bashki apo shtet tjetër;
- kontrolli i përgjithshëm i regjistrimit të popullsisë verifikon mungesën tënde në vendbanimin e regjistruar, ose në rast se, pas verifikimesh të numërta, nuk je i pranishëm në vendbanimin e deklaruar;
- nuk është përtëritur deklarata e vendbanimit të zakonshëm 1 vit pas mbarimit të afatit të lejeqëndrimit e nuk ke bërë kërkesë për përtëritjen e tij. Sidoqoftë, në këtë rast, do të lajmërohesh e do të të jepet mundësia të ndërhysh brenda 30 ditësh.

6. Letërnjoftimi

Për të marrë letërnjoftimin duhet të paraqitesh në zyrën e gjendjes civile me:

- ✓ **3 fotografi të njëjta e të bëra kohët e fundit;**
- ✓ **pasaportë të vlefshme;**
- ✓ **lejeqëndrim të vlefshëm apo kërkesë për ripërtëritjen e lejeqëndrimit, afati i të cilit ka mbaruar.**

Duhet të kesh parasysh se letërnjoftimi:

- ka afat pesë-vjeçar dhe nuk vlen për të dalë nga Italia;
- nuk vlen për të dalë nga Italia, dhe nuk i jep të drejtën të huajit të qëndrojnë në Itali në mungesë të lejeqëndrimit apo kur i ka mbaruar afati, përveçse në rastin kur ka marrëveshje ndërkombëtare që parashikojnë një trajtim tjetër. ●



Të huajt dhe arsimi

Arsimi në sistemin tonë është një e drejtë-detyrim: një e drejtë dhe në të njëjtën kohë është i detyrueshëm deri në moshën 16-vjeçare. Kjo e drejtë-detyrim i garantohet nënshtetasit të huaj që qëndron rregullisht në Itali njësoj si një nënshtetasi italian.

NJOFTIM: normativa ligjore mbi lejeqëdrimet është modifikuar nga Dekreti Legjislativ i 10 gushtit 2007, n. 154: "Zbatimi i udhëzimit 2004/114/CE, mbi kushtet e nevojshme për pranimin e nënshtetasve të shteteve të treta për arsye studimi, shkëmbim nxënësish, stazh pa pagesë o shërbim vullnetar", i publikuar në Gazetën Zyrtare (Gazzetta Ufficiale) n. 216 i 17 shtatorit 2007.

1. E drejta e studimit për të miturit e huaj që ndodhen në Itali

Të miturit e huaj:

- **kanë të drejtë të studiojnë** njësoj si nënshtetasit italian pamvarësisht nga gjendja tyre e rregullt apo jo, në Itali;
- **i nënshtrohen detyrimit shkollor** sipas ligjeve në fuqi mbi arsimin;
- **mund të kërkojnë të regjistrohen** në çfarëdo periudhë të vitit shkollor.

Në mungesë të dokumentacionit të gjendjes civile apo duke pasur vetëm dokumente të parregullt o të pakompletuar, njëri prej prindërve ose tutori do të deklarojë të dhënat e fëmijës nën përgjesinë e tij. Në këtë rast, regjistrimi i të miturit është i kushtëzuar, por kjo nuk pengon përfundimin e kurseve apo marrjen e dëshmive të tyre në cilindo nivel o forme shkollore.

2. Si bëhet regjistrimi

Të miturit e huaj që duhet të ndjekin shkollën e detyrimit, regjistrohen nga prindërit ose nga tutori në klasën që i përket moshës së tij, përveç rastit kur trupi mësimor vendos regjistrimin në një klasë tjetër në bazë të disa kriterëve të veçanta (programi mësimor në

vendin ku janë kryer studimet e mëparshme; verifikimi i njohurive, aftësive dhe nivelit përgatitor të nxënësit; studimet e përfunduara nga nxënësi).

3. E drejta e studimit e nënshtetasve të huaj në moshë madhore që ndodhen në Itali

E drejta e studimit i njihet me ligj edhe të huajve në moshë madhore.

Kjo e drejtë shprehet mbi të gjitha në sajë të nevojës tënde për të njohur gjuhën italiane (me anë të alfabetizimit në nivele të ndryshme).

Por, nëse do të përfundosh shkollën tetë-vjeçare e të marrësh dëftesën e lirimt, duhet t'i paraqesësh kërkesë drejtorit të shkollës ku duhet të përcaktosh edhe të dhënat e tua personale e studimet e kryera, po ashtu duhet të njohësh mirë italishten e të kesh një lejeqëndrim të rregullt.

Nëse ke kryer shkollën e detyrimit dhe dëshëron të vazhdosh studimet për të përfunduar shkollën e mesme, mund të regjistrohesh direkt në klasat më të larta.

4. Asistenca shkollore për nënshtetasit e huaj me vendbanim jashtë Italisë

Nëse ke vendbanim jashtë Italisë dhe do të frekuentosh kurse studimi të mesme apo studime tekniko-profesionale mund të kërkoresh vizë hyrjeje për arsye studimi në ambasadën o konsullatën italiane në vendin tënd.

Kushtet që duhen përmbushur:

- ✓ moshë mbi 14-vjeçare
- ✓ certifikatë regjistrimi e lëshuar nga shkolla apo instituti italian në kursin profesional o të specializimit të përzgjedhur;
- ✓ policë sigurimi për kurat mjekësore o për shtrimin në spital nëse nuk ke të drejtë të

NË ITALI SIPAS RREGULLAVE

shfrytëzosh shërbimet shëndetësore në Itali;

- ✓ dokumente që provojnë se të ardhurat vjetore janë baraz me të paktën gjysmën e shumës vjetore të çekut social;
- ✓ dokumente që provojnë ekzistencën e shumës së nevojshme për rrugën e kthimit në vendin tënd mbasi të kesh përfunduar studimet.

Duhet verifikuar edhe:

- përputhshmëria e kurseve që do të ndiqen në Itali me ato të kryera më parë;
- përputhshmëria e programit shkollor që do të ndiqet në Itali me kërkesat e tua formuese e kulturore reale.

Kur bëhet fjalë për një të mitur, duhen verifikuar edhe masat tutelare në favor të tij.

5. Çfarë duhet bërë pas marrjes së vizës

Pasi të kesh marrë vizën, brenda 8 ditësh nga hyrja në Itali, duhet të paraqitesh në Kuesturën e zonës ku do të vendosësh vendbanimin e të kërkohsh lejqëndrimin për arsye studimi.

Nëse bëhet fjalë për një të mitur, atëherë këto veprime do të bëhen nga prindërit o nga tutori: lejqëndrimi do të lëshohet brenda 20 ditësh dhe do të ketë afatin e vizës së hyrjes.

6. Studim e Punë

Me lejqëndrimin për arsye studimi mund edhe të kryesh punë të nënvarur për të shumtën 20 orë në javë ose 1040 orë në vit, me autorizimin e institutit shkollor dhe duke respektuar kufizimet dhe përkujdesjet e duhura që parashikon ligji në rastin e të miturve.

PRANIMI NË UNIVERSITET

Brenda 31 Dhjetorit të ç'do viti, institutet e studimeve të larta vendosin numrin e studentëve të huaj që do të pranojnë për herë të parë në kurset e studimeve universitare për vitin e ardhshëm. Pranimi varet po ashtu edhe nga kapaciteti i strukturave dhe nga kalimi i provave të pranimit.

Përfaqësitë diplomatike o konsullore italiane kompetente, për pranimin në universitet, lëshojnë një deklaratë mbi vlefshmërinë e dëftesës së shkollës së mesme të vendit tënd,



bashkë me informacionet mbi shkallën e vlerësimit e sistemin ku mbështetet gjykimi i dhënë në dëftesë.

1. Ku mund të kërkohsh vizën për studime

Mund të kërkohsh vizën e hyrjes (edhe për të afërmit që do merrni me vete) në përfaqësinë diplomatike o konsullore italiane në vendin tënd.

Në kërkesë duhet të specifikosh:

- ✓ të dhënat personale të plota e ato të të afërmeve që do merrni me vete;
- ✓ të dhënat e pasaportës apo të një dokumenti tjetër të barazvlershëm;
- ✓ vendin ku do të shkosh;
- ✓ arsyet dhe kohëzgjatjen e lejqëndrimit.

Duhet po ashtu të bashkëngjitesh:

- ✓ pasaportën apo një dokument tjetër të barazvlershëm;
- ✓ dokumentacionin që përshkruan objektivin e udhëtimit;
- ✓ kushtet e strehimit;
- ✓ ekzistencën e mjeteve të jetesës të mjaftueshme për rrugën dhe qëndrimin;
- ✓ deklaratën e vlefshmërisë së dëftesës së shkollës së mesme që lëshojnë përfaqësitë diplomatike e konsullore të pranishme në vendin tënd.

2. Si dhe kur mund të përtërish lejqëndrimin

Lejqëndrimi për arsye studimi mund të

përtërihet nëse:

- gjatë **vitit të parë** shkollor do të kesh kaluar pozitivisht një provim dhe
- në **vitet më pas**, do të kesh kaluar pozitivisht dy provime në vit (e sidoqoftë nuk mund të përtërihet përtej tre vjetësh pas kohëzgjatjes së kursit të përzgjedhur)

Lejeqëndrimi mund të përtërihet edhe për të ndjekur një kurs specializimi apo doktorati të plotë duke e përtëritur vit për vit.

3. Nëse gjendesh në Itali

Mund të ndjekësh kurset universitare njësoj si studentët italian:

- në qoftë se ke vendbanim (*residenza*) në Itali dhe ke një lejeqëndrim për periudhë të gjatë, ose për punë të nënvarur, për punë të pavarur, për arsye familjare, për strehim politik o humanitar e për arsye fetare;
- n.q.s. qëndron rregullisht në Itali prej të

paktën 1 viti e me një diplomë shkolle të mesme të kryer në Itali;

- nëse, kudo qoftë vendbanimi (*residenza*), ke një diplomë përfundimtare të një shkolle italiane jashtë shtetit ose të një shkolle të huaj o internacionale në Itali apo jashtë saj por të njohur nga marrëveshje të dyanshme o nga norma ligjore të veçanta.

4. Shndërrimi i lejeqëndrimit për studim në lejeqëndrim për punë

Nëse ke marrë një diplomë universitare mund të shndërrosh lejeqëndrimin për studim në lejeqëndrim për punë pa hyrë në quatat e parashikuara (që si rrjedhim do të modifikohen për vitin që do të ndjekë). Për këtë, duhet të paraqitësh kërkesë të posaçme, bashkë me diplomën universitare, pranë Sportelit Unik. ●

Shërbimi sanitar për nënshtetasit e huaj

Për nënshtetasit e huaj, komunitar ose jo-komunitar, regjistrimi në Shërbimin Sanitar Kombëtar (S.S.N.) garanton ç'do shërbim shëndetësor të parashikuar nga ligji njësoj si për nënshtetasit italian për sa i përket kontributeve të detyrueshme, shërbimeve shëndetësore të ofruara në Itali nga S.S.N. dhe kohëzgjatjes.

1. Kush është i detyruar të regjistrohet në S.S.N.

- Nënshtetasit e huaj që kanë lejeqëndrim të rregullt dhe kryejnë punë të nënvarur o të pavarur apo që janë të regjistruar në listat e punësimit;
- nënshtetasit e huaj me lejeqëndrim të rregullt o që kanë kërkuar ripërtëritjen e lejeqëndrimit për punë të nënvarur o të pavarur, për arsye familjare, për strehim politik ose për kërkesë strehimi, në pritje adoptimi,

për kujdestari, për marrjen e nënshtetësisë italiane apo për arsye fetare;

- të afërmit në ngarkim (me lejeqëndrim të rregullt) të atyre nënshtetasve të huaj që i përkasin kategorive të mësipërme.

Nuk janë të detyruar të regjistrohen në S.S.N. nënshtetasit e huaj që nuk hyjnë në kategoritë e mësipërme, por sidoqoftë, ata duhet të sigurohen për sëmundje, aksidente dhe për shtatzani me anë të një police sigurimi të vlefshme edhe për familjarët në ngarkim në territorin italian.

2. Ku bëhet regjistrimi

Për t'u regjistruar në S.S.N. duhet të paraqitësh në ASL-in (qendër sanitare lokale) të zonës ku ke vendbanimin ose ku jeton efektivisht (siç është specifikuar në lejeqëndrim), me:

- ✓ **një dokument identiteti personal** ▶

NË ITALI SIPAS RREGULLAVE

- ✓ kodin fiskal
- ✓ lejeqëndrim
- ✓ një deklaratë personale (*autocertificazione*) mbi vendbanimin apo banesën tënde (konsiderohet banesë, vendi ku jeton prej të paktën tre muajsh).

Në momentin e regjistrimit mund të zgjedhësh mjekun e familjes o pediatrin e fëmijëve të tu.

3. Ç'afat ka regjistrimi

■ Regjistrimi ka afat të njëjtë me atë të lejeqëndrimit dhe nuk skadon gjatë periudhës së përtëritjes së tij: pra mund të përtërihet duke paraqitur në ASL dokumentacionin e përtëritjes së lejeqëndrimit.

■ në rast se përtëritja e lejeqëndrimit nuk realizohet ose anulohet apo në rast përjashtimi nga Italia, regjistrimi nuk ka më vlerë përveçse kur i interesuari mund të vërtetojë se ka bërë apel kundër vendimeve në fjalë.

4. Ç'farë shërbimesh ke të drejtë të shfrytëzosh

Në momentin që do të regjistrohesh do të të dorëzojnë një dokument "*Tesserino sanitario personale*", që të jep të drejtën të përfitosh falas ose me pagesën e një shume të caktuar (*Ticket sanitario*) – varet nga krahina ku ndodhesh – shërbimet që ndjekin: vizitat mjekësore të përgjithshme ose të specializuara, vizitat mjekësore në shtëpi, shtrimin në spital, vaksinimet, analizat e gjakut, radiografitë, ekografitë, ilaçet, asistencë rehabilituese dhe për protesta.

NËNSHTETASIT E HUAJ TË PAREGJISTRUAR NË S.S.N.

Nëse qëndron rregullisht në Itali dhe nuk hyn në kategoritë e atyre që janë të detyruar të regjistrohen në S.S.N., ke dy mundësi:

a) të regjistrohesh vullnetarisht në S.S.N.

bashkë me të afërmit e tu n.q.s. janë në Itali. Mund të kryesh regjistrimin vullnetarisht nëse:

- ✓ ke një lejeqëndrim me afat më të gjatë se tre muaj (përveç lejeqëndrimit për studim)
- ✓ je i regjistruar bashkë me të afërmit e tu në listat e atyre që mund të shërbehën nga ASL-i i zonës së vendbanimit (*residenza*) ose të banesës (në rast regjistrimi për herë të parë) të specifikuar në lejeqëndrimin tënd.



Regjistrimi nuk është i mundshëm nëse ke një lejeqëndrim për kura mjekësore.

Në këtë rast shërbimet do të garantohen në ASL vetëm duke paguar tarifat e parashikuara nga ligji dhe që mund të ndryshojnë nga krahina në krahinë. N.q.s. nuk ke të ardhura të mjaftueshme do të të sigurohen shërbimet mjekësore në ambulator ose në spital kur janë të domosdoshme, të vazhdueshme apo urgjente për sëmundje, aksidente apo për programe mjekësore parandaluese të sëmundjeve (si p.sh. vaksinimi), në strukturat publike o private të autorizuar.

b) mund të sigurohesh, me një institut sigurimesh italian o të huaj me një policë që ka vlerë në Itali, **për sëmundje, aksidente o shtatzani.**

Cilat janë shërbimet që garantohen

- ✓ ato në mbrojtje të shtatzanisë dhe të maternitetit;
- ✓ ato në mbrojtje të shëndetit të të miturit;
- ✓ vaksinimi sipas normave ligjore apo sipas fushatave për mbrojtjen kolektive paraprake të autorizuar nga Krahinat (*Regione*);
- ✓ masat ndërkombëtare për parandalimin e sëmundjeve;
- ✓ parandalimi, diagnoza dhe kurimi i sëmundjeve infektive.

Mund të deklaroësh gjendjen e varfërisë dhe pamundësinë për të paguar shërbimet e S.S.N.-së me një deklaratë personale që duhet të paraqisësh në strukturën shëndetësore që do të ofrojë shërbimet.

TË HUAJT ME QËNDRIM TË PARREGULLT

Edhe nëse hyrja apo qëndrimi yt në Itali janë të parregullt sipas normave ligjore, ke të drejtë të shfrytëzosh shërbimet shëndetësore urgjente ose të domosdoshme, edhe kur janë të vazhdueshme, në ambulator o spital për

sëmundje apo aksidente, në strukturat publike o në strukturat private të njohura nga shteti.

Për këtë arsye duhet të kërkohet në një **ASL tesarën STP (I Huaj me Qëndrim të Përkohshëm)**, që ka afat gjashtë mujor me mundësi përtëritjeje. Për ta marrë duhet të deklarosh:

- ✓ të dhënat e tua personale;
- ✓ që nuk ke të ardhura të mjaftueshme.

Mund të kërkohet tesarën edhe pa specifikimin e emrit dhe mbiemrit.

Me tesarën S.T.P. ke të drejtë:

- ✓ të shfrytëzosh shërbimet shëndetësore kryesore;
- ✓ të shtrohesh urgjent ose normalisht në spital e në *day-hospital* (shtrim ditor);
- ✓ shërbime urgjente ose thelbësore në ambulator ose në spital edhe nëse janë të vazhdueshme, për sëmundje o aksidente.

Shfrytëzimi i strukturave shëndetësore nuk do të thotë, në asnjë mënyrë, që prania jote në Itali do t'i bëhet e njohur autoriteteve publike. Por duhet të kesh parasysh se për raste të veçanta (për arsye rëndi apo për shkaqe të rënda) Autoritetet Publike mund të marrin informacione ashtu siç ndodh edhe për nënshtetasit italian.

HYRJA DHE QËNDRIMI PËR KURA MJEKËSORE

1. Ku dhe kur duhet kërkuar viza e hyrjes

Nëse do të kurohesh në Itali mund të

kërkohet, edhe për personin që mund të të shoqërojë, një vizë të posaçme në përfaqësinë diplomatike o konsullore italiane në vendin tënd.

Brenda 8 ditësh, nga data e hyrjes në Itali, duhet të kërkohet lejeqëndrimin përkatës në Kuesturën e zonës ku do të kurohesh, në rast të kundërt, qëndrimi yt do të konsiderohet i parregullt.

2. Dokumentacioni i nevojshëm

- ✓ çertifikata mjekësore që vërteton patologjinë tënde
- ✓ deklaratat e strukturës shëndetësore italiane të përgjegdhur, publike o private në të cilën përshkruhet terapia, data e fillimit, kohëzgjatja e mundshme e parashikuar e saj dhe e shtrimit në spital;
- ✓ dëshmia e derdhjes së një paradhënieje garancie (30% e shumës) të shpenzimeve të parashikuara për kurat e nevojshme në favor të strukturës së zgjedhur;
- ✓ dokumentacioni që vërteton disponueshmërinë e të ardhurave të mjaftueshme për të paguar shpenzimet shëndetësore e të qëndrimit në Itali jashtë strukturës shëndetësore;
- ✓ dokumentacioni që vërteton disponueshmërinë e të ardhurave të mjaftueshme për ty e për personin që mund të të shoqërojë

Shënim: Dokumentacionit të lëshuar jashtë shtetit i duhet bashkëngjitur përkthimi në gjuhën italiane.

Nënshtetësia

Nënshtetësia italiane bazohet në principin e prejardhjes për të cilin fëmijët e lindur nga nënë e/o baba me nënshtetësi italiane kanë të drejtë të jenë italianë. Për nënshtetasit e huaj, nënshtetësia italiane mund të merret në rast:

- A. martesë me nënshtas italian**
- B. vendbanimi (*residenza*) në Itali**

A. DHËNIA E NËNSHTETËSISË PËR MARTESË

1. Mund të bësh kërkesë nëse:
 - je martuar me një nënshtetas/e italian/e dhe **ke vendbanim (*residenza*) të rregullt në Itali prej të paktën gjashtë muajsh nga data e martesës;**
 - ke vendbanim jashtë shtetit, për tre vjet, nga data e martesës.

Nërkohë nuk duhet të kenë ndodhur

NË ITALI SIPAS RREGULLAVE

zgjidhja, anulimi, ose ndërprerja e martesës në gjendjen civile apo të jetë në zhvillim e sipër një ndarje ligjore.

2. Çfarë duhet bërë

Kërkesa për nënshtetësinë prezantohet në Prefekturën (UTG) e zonës ku ke vendbanimin (*residenza*); duhet të përpilosh formularin e përcaktuar, ku duhet të ngjitetsh një pullë-taksë prej 14,62 euro.

Nëse ke vendbanimin (*residenza*) jashtë shtetit, mund t'ja paraqesësh kërkesën pas tre vjet martese, Autoriteteve Konsullore.

3. Dokumentacioni i duhur

Kërkesës i duhen bashkëngjitur këto dokumente:

✓ **çertifikata e lindjes** e përkthyer, dhe e legalizuar siç është e specifikuar në formularin e kërkesës;

✓ **çertifikata penale** e lëshuar në vendin tënd, po ashtu e përkthyer dhe legalizuar siç është e specifikuar në formularin e kërkesës;

Mund të bësh një deklaratë personale (*autocertificazione*) duke përpiluar pikat e posaçme në formularin e kërkesës në vend të dokumenteve që specifikojnë informacionet e mëposhtme:

- ✓ vendbanimin sipas zyrës së gjendjes civile;
- ✓ përbërjen e grupit familjar;
- ✓ gjendjen penale aktuale në territorin italian;

Në mënyrë të ngjashme mund të përpilosh dhe nënshkruash në vendin e caktuar në formularin e kërkesës, një deklaratë zëvendësuese të aktit noterial në vend të çertifikatave:

- ✓ të nënshtetësisë së bashkëshortit;
- ✓ kushtet e vlefshmërisë së martesës.

Nëse je **nënshtetas BE**, mund të bësh një deklaratë personale mbi gjendjen tënde penale në vendin tënd. Mjafton të përpilosh formularin në pikat e posaçme.

Nëse je **refugjat politik**, mund të nënshkruash një deklaratë zëvendësuese të aktit noterial mbi të dhënat personale apo gjendjen penale në vendin tënd.

Nëse kur paraqet kërkesën, dokumentacioni nuk është i plotë,

Prefektura do të të kërkojë të riparaqitesh për ta kompletuar brenda një periudhe të caktuar përtej të cilës kërkesa do të deklarohet e papranueshme.

Kohëzgjatja për shqyrtimin e praktikës është 730 ditë nga data e paraqitjes së kërkesës nëse është e plotë dhe e rregullt.

Nëse shqyrtimi i praktikës nga ana e Prefekturës ka rezultat pozitiv dhe pas verifikimit të mungesës së pengesave në lidhje me sigurinë e Shtetit italian, jepen udhëzimet për vendimin e dhënjes së nënshtetësisë italiane.

Ministri i Punëve të Brendshme nënshkruan dekretin e dhënies së nënshtetësisë, që do të të bëhet i njohur nga Prefektura e zonës ku ke vendbanimin.

Brenda 6 muajsh nga njoftimi i vendimit, duhet të bësh betimin në Bashkinë ku ke vendbanimin dhe nga dita e nesërme do të jesh nënshtetas italian.

Pasi të kesh marrë nënshtetësinë italiane, nuk duhet të heqësh dorë nga nënshtetësia e mëparshme.

4. Rastet kur parashikohet që kërkesa të hidhet poshtë

- në rast rreziku për sigurinë e Republikës;
- në rast vendimi fajësie, të marrë në Itali apo jashtë shtetit, për krime të rënda.

B. DHËNIA E NËNSHTETËSISË PËR VENDBANIM (*RESIDENZA*)

1. Mund të kërkoresh nënshtetësinë italiane nëse:

- nuk je nënshtetas BE dhe ke vendbanim të rregullt në Itali prej të paktën 10 vjetësh;
- je nënshtetas BE dhe ke vendbanim të rregullt në Itali prej të paktën 4 vjetësh;
- je apolid ose refugjat politik dhe ke vendbanim të rregullt në Itali prej të paktën 5 vjetësh;
- je fëmijë ose nip/mbesë (pasardhës në linjë të drejtpërdrejtë të shkallës së dytë i një nënshtetasi të lindur italian) dhe ke vendbanim të rregullt në Itali prej të paktën 3 vjetësh;
- ke lindur në Itali dhe ke vendbanim të



rregullt në Itali prej të paktën 3 vjetësh;

■ je në moshë madhore e i adoptuar nga një nënshtetas italian, me vendbanim të rregullt në Itali prej 5 vjetësh, nga data e adoptimit;

■ ke kryer shërbim, edhe jashtë shtetit, për të paktën 5 vjet nën vartësinë e Shtetit Italian (në rast shërbimi jashtë shtetit nuk është e nevojshme të vendosësh vendbanim në Itali e mund t'i paraqesësh kërkesë autoriteteve konsullore kompetente).

2. Çfarë duhet bërë

Kërkesa për lejeqëndrim prezantohet në Prefekturën (UTG) e zonës ku ke vendbanimin (*residenza*); duhet të përpilosh formularin e caktuar, ku duhet të ngjitësh pullë-taksën prej 14,62 euro.

3. Dokumentacioni i duhur

- ✓ **çertifikata e lindjes** e përkthyer, dhe e legalizuar siç është e specifikuar në formularin e kërkesës;
- ✓ **çertifikata penale** e lëshuar në vendin tënd, po ashtu e përkthyer dhe e legalizuar siç është e specifikuar në formularin e kërkesës;

Mund të bësh një deklaratë personale (*autocertificazione*) duke përpiluar pikat e posaçme në formularin e kërkesës në vend të dokumenteve të mëposhtëm:

- ✓ vendbanimi sipas zyrës së gjendjes civile;
- ✓ përbërja e grupit familjar;
- ✓ gjendja penale aktuale në territorin italian;
- ✓ të ardhurat e tre viteve të fundit.

Nëse je **nënshtetas BE**, mund të bësh një deklaratë personale mbi gjendjen tënde penale në vendin tënd. Mjafton të përpilosh formularin në pikat e posaçme.

Nëse je **refugjat politik**, në vend të

dokumentacionit të mësipërm, mund të nënshkruash një deklaratë zëvendësuese të aktit noterial mbi të dhënat personale të sakta dhe gjendjen penale në vendin tënd si edhe kopjen e vërtetimit të statusit të refugjatit politik.

Mund të deklarosh, në vendin e caktuar të formularit, që një paraardhësi yt është nënshtetas i lindur italian me anë të një deklarate zëvendësuese të aktit noterial.

Nëse kur paraqit kërkesën, dokumentacioni nuk është i plotë, Prefektura do të të kërkojë të rikthehesh për ta kompletuar brenda një periudhe të caktuar përtej të cilës kërkesa do të deklarohet e papranueshme.

Nëse shqyrtimi i praktikës nga ana e Prefekturës ka rezultat pozitiv dhe pas verifikimit të mungesës së pengesave në lidhje me sigurinë e Shtetit italian, jepen udhëzimet për vendimin e dhënjes së nënshtetësisë italiane.

Kohëzgjatja për shqyrtimin e praktikës është 730 ditë nga data e paraqitjes së kërkesës nëse është e plotë dhe e rregullt. Ministri i Punëve të Brendshme nënshkruan dekretin e dhënies së nënshtetësisë, që do të të bëhet i njohur nga Prefektura e zonës ku ke vendbanimin.

Brenda 6 muajsh nga njoftimi i vendimit, duhet të bësh betimin në Bashkinë e vendbanimit dhe nga dita e nesërme do të jesh nënshtetas italian.

Pasi të kesh marrë nënshtetësinë italiane, nuk duhet të heqësh dorë nga nënshtetësia e mëparshme.

4. Raste në të cilat kërkesa hidhet poshtë

Në këto raste, ligji i njeh Administratës të drejtën e vlerësimit të elementeve që ka në dorë. Mospranimi mund të varet përveçse nga arsye lidhur me sigurinë e Republikës, edhe nga mungesa e kohës së kërkuar të vendbanimit të rregullt, pamjaftueshmëria e të ardhurave, dënime penale, pamjaftueshmëria e integritimit në shoqërinë italiane. ●